

patur aprovimin e të gjithëve, kjo këngë është marë gojë në për gojë dhe kështu është bërë pronja e të gjithëve. Me kohë është haruar edhe emëri i krionjësit të saj dhe gjithsisili ka shtuar, ka pakësuar ose edhe ka ndruar pjesat e ndryshme të këngës si pas ëndës së tij. Për shëmbëll, këngën e Zanës e kam gjetur në Shosh të Dukagjinit më një tjetër formë.

Prej kësaj shëmbëlle rjeth edhe fakti që një këngë me kohë jo vetëm ndryshon po edhe udhëton pe një vënt të larkmë më një tjetër. Vendi i cili e mer, e ndryshon pas karakterit të tij dhe kjo gjithë sjell pengime në të gjeturit e origjenës të këngës.

S' munt të jenë, si vjershat e tjera, çfaqja e ndjenjave ose të mendimeve personale të krionjësit, po përgjithësisht të grupit, shpirti i të cilit pasqyrohet në to. Këngët popullore janë impersonele.

Ndonëse të thjeshta nga gjithë pikpamjet, këngët popullore kanë një bukuri të madhe sepse përmbajnë fjalë edhe ekspresione poetike të cilat e mallëngjejnë shpirtin e njeriut. Në to ekziston fryma poetike, dhe nuk janë të shplara e të tharta si disa vjersha moderne, të cilat janë një grumbullim fjalësh me rithm.

Është vënë re se shumica e këngëve popullore do kenë nonjë "refren" ose një përsë-